Raporti për të Drejtat e Njeriut për vitin 2010: Hyrje

BYROJA E DEMOKRACISË, TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE PUNËS
Raportet e Vendeve mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut për vitin 2010
8 prill, 2011

Hyrje e Raporteve të Vendeve mbi Praktitat e të Drejtave të Njeriut për Vitin 2010

Ky raport jep detaje enciklopedike mbi gjendjen e të drejtave të njeriut për më shumë se 190 shtete për vitin 2010. Megjithatë, për shkak se ky raport po botohet tre muaj pas hyrjes së vitit të ri, perspektiva jonë në shumë prej këtyre çështjeve kuadrohet tani nga ndryshimet dramatike që kanë përfshirë vendet e Lindjes së Mesme në vitin 2011. Nuk mund të parashikojmë në këtë çast rezultatin e këtyre ndryshimeve, dhe nuk do të dimë as ndikimet afatgjata për vitet e ardhshme. Dinamikat e brendshme janë të ndryshme në secilin prej këtyre vendeve, kështu që nuk është e përshtatshme të bëhet analizë gjithëpërfshirëse për të gjithë rajonin. Në vende si Tunizia dhe Egjipti, po shikojmë kërkesa popullore për pjesëmarrje të ndjeshme politike, për liri themelore dhe mundësi më të mëdha ekonomike. Këto kërkesa janë të thella, janë të kultivuara në vend dhe drejtohen nga aktivistë të rinj, shumë prej tyre të rinj edhe në moshë. Këta qytetarë kërkojnë të ndërtojnë demokraci të qendrueshme në vendet e tyre me qeveri që respektojnë të drejtat universale të njeriut për popullin e tyre. Nëse këto do të kenë sukses, rajoni i Lindjes së Mesme, e bashkë me të e gjithë bota do të përmirësohen.

Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të monitorojnë nga afër situatat në këto vende, duke pasur parasysh faktin se kalimi për në demokraci nuk bëhet automatikisht dhe do kohë e vëmendje të kujdesshme. Në Egjipt presim heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, të cilën Këshilli i Lartë i Forcave të Armatosura ka premtuar ta bëjë përpara zgjedhjeve parlamentare. Në Tunizi inkurajohemi nga krijimi i një komisioni fakte-mbledhës për të hetuar abuzimin me të drejtat e njeriut që u bë gjatë kryengritjes.

Ndërkohë që ne trajtojmë këto dhe ndikimet e tjera afatshkurtra, historianët do të përfitojnë nga koha dhe perspektiva për të na ndihmuar të kuptojmë shkaqet që nxitën këto lëvizje. Është e dukshme që tre prirje çuan në zhvillimin e tyre dhe ndryshimeve të tjera që ndodhën në mbarë botën në vitin 2010. E para është rritja shpërthyese e organizatave përkrahëse joqeveritare të përqendruara në një gamë të gjerë çështjesh dhe kauzash të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Pesëdhjetë vite më parë, kur u krijua Amnesty International (Amnistia Ndërkombëtare), pak vende përtej Amerikës

Veriore dhe Europës Perëndimore kishin organizata të të drejtave të njeriut me bazë lokale. Sot ekzistojnë organizata joqeveritare (OJQ) lokale në pothuaj çdo vend të botës. Këto organizata kanë pësuar rritje tepër të madhe; në shumë vende organizata të tilla qytetare janë krijuar më vështirësi shumë të mëdha e vetëm si pasojë e vullnetit të fortë të aktivistëve për të drejtat e njeriut, të cilët kanë marrë përsipër rreziqe të mëdha personale. Sekretarja Klinton theksoi rëndësinë e këtyre organizatave në një fjalim që mbajti në korrik të vitit 2010 në Krakou, Poloni, përpara Komunitetit të Demokracisë. Sipas fjalës së saj, "shoqëritë bëjnë përpara kur shtetasit që përbëjnë këto grupe kanë fuqinë të shndërrojnë interesat e përbashkët në veprime të përbashkëta që i shërbejnë të mirës së përbashkët."

Në shoqëritë e mbyllura, ku qeveritë shtypëse duan të kontrollojnë dhe ndrydhin debatin mbi çështje delikate politike dhe sociale, qeveritë i shohin këto organizata qytetare të pavarura në vend si kërcënim e jo si burim, dhe mbrojtësit e demokracisë dhe të drejtave të njeriut veçohen për trajtime tejet të ashpra. Për shembull, në Bjellorusi mbi 700 aktivistë prodemokracisë, përfshirë edhe shtatë kandidatë presidencialë, u arrestuan gjatë demonstrimeve publike pas zgjedhjeve presidenciale të njollosura të dhejtorit të vitit 2010. Në javët që pasuan u sulmuan zyrat dhe shtëpitë e përfaqësuesve të shoqërisë civile, gazetarëve të pavarur dhe aktivistëve politikë, si pjesë e përpjekjes për të ndrydhur veprimtaritë e pavarura politike dhe lirinë e fjalës.

Në një pjesë të mirë të viteve të fundit, më shumë se 90 qeveri janë përpjekur të miratojnë ligje dhe rregullore kufizuese, duke vështirësuar kështu mundësinë e organizatave për t'u regjistruar, për të vepruar të lira apo për të marrë fonde të jashtme. Si emblemë e këtyre përpjekjeve ishte një ligj i propozuar për OJQ-të në Kamboxhia, i paraqitur në dhjetor. Ligji do t'u ngarkonte kërkesa të rënda raportuese OJQ-ve, do të ngrinte pengesa të mëdha për regjistrimin e OJQ-ve të huaja, do t'u kërkonte OJQ-ve të huaja të bashkëpunonin me qeverinë dhe do të nxirrte të jashtëligjshme OJQ-të e paregjistruara. Në Etiopi hyri në fuqi në shkurt një ligj i ri për organizimin e shoqërisë civile, pas një periudhe të hijshme një vjeçare. Ligji i ndalon bamirësitë, shoqëritë dhe shoqatat që marrin më shumë se 10 përqind të fondeve të tyre nga burime të jashtme që të angazhohen në aktivitete që nxisin të drejtat e njeriut dhe demokracinë; të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara; barazinë mes kombeve, kombësive, popujve, gjinive e feve; zgjidhjen e konflikteve ose pajtimin, dhe promovimin e drejtësisë. Gjatë periudhës së hijshme organizatat kryesore mbrojtëse të të drejtave të njeriut u përshtatën duke u riregjistruar ose si bamirësi vendase, që do të thoshte se nuk mund të mblidhnin më shumë se 10 përqind të fondeve të tyre nga donatorë të huaj, ose si "Bamirësi Rezidente," status që u lejonte donacione por ndalonte aktivitete

në zonat e renditura si rezidencë. Ekzistonin 3522 organizata të regjistruara përpara se të miratohej ligji për organizimin e shoqërisë civile; pas ligjit mbetën vetëm 1655.

Sekretarja Klinton i veçoi këto kufizime shqetësuese mbi shoqërinë civile në fjalimin e saj në Krakou, kur përmendi një "numër vendesh ku po mbyllen muret përpara organizatave civile" dhe paralajmëroi se kur "qeveritë shtypin të drejtën e qytetarëve për të punuar së bashku, siç kanë bërë përgjatë historisë, shoqëritë bien në amulli dhe shkatërrim." Siç e kemi parë në Lindjen e Mesme dhe gjetkë, qeveritë nuk mund ta shtypin shoqërinë civile pafundësisht, dhe nuk mund ta shtypin kurrë në mënyrë legjitime.

Prirja e dytë e rëndësishme është rritja shumë e madhe e përdorimit të Internetit, telefonave celularë dhe teknologjive të tjera lidhëse që mundësojnë komunikime të menjëherëshme për miliarda njerëz në mbarë globin. Siç vërejti Sekretarja Klinton në një fjalim kohët e fundit mbi lirinë e Internetit, Interneti është bërë sheshi i qytetit për shekullin e 21-të. Janë thënë e shkruar shumë në lidhje me ndikimin e këtyre teknologjive lidhëse, se si ato u kanë dhënë mundësinë egjiptianëve dhe tunizianëve të mobilizoheshin në javët dhe muajt përpara se të fillonin demonstratat e vërteta. Megjithëse është kuraja e vetë popullit që e drejtoi atë dhe shërbeu si forcë shtytëse, nuk mund të mohohet ndikimi i shtuar i këtyre teknologjive të reja së bashku me fuqinë e stacioneve televizive dhe Internetit për të shfaqur video të bëra nga shtetas duke përdorur telefona celularë.

Sot ka më shumë se dy miliardë njerëz që mund të përdorin Internetin në shumicën e vendeve të botës, dhe përreth pesë miliardë abonime në telefoni celulare. Këto numra janë në projekt të rriten thellësisht në 15 vitet e ardhshme. Ndërsa gjithmonë e më shumë njerëz munden të përdorin këto teknologji mbresëlënëse, dhe i kanë përdorur në fakt si për të mbledhur e dhënë informacion mbi të drejtat e njeriut edhe për të komunikuar me aktivistë të tjerë, një numër në rritje qeverish po përdorin më shumë kohë, pará dhe vëmendje në përpjekje për të pakësuar mundësinë e përdorimit të këtyre mjeteve komunikimi. Më shumë se 40 qeveri përdorin tani një kombinim kufizimesh rregullatore, kontrolle teknike në lidhje me përdorimin e Internetit, dhe teknologji për të shqypur fjalën dhe dhunuar privacinë e atyre që i përdorin këto teknologji që zhvillohen kaq shpejt.

Në Arabinë Saudite në vitin 2010 qeveria kufizoi mundësinë e përdorimit të Internetit dhe ndërhyri në privacinë e shtetasve ndërsa ata ishin online (në linjë direkte). Komisioni zyrtar i Komunikimit dhe Teknologjisë së Informacionit (CITC) monitoronte në mënyrë të papërshtatshme postën elektronike dhe dhomat e diskutimit në Internet dhe

bllokonte faqe interneti, përfshirë dhe faqe për Hinduizmin, Judaizmin, Krishtërimin dhe të disa formave të Islamit që përcaktoheshin si të papajtueshme me ligjin Sharia dhe rregulloren kombëtare. Në Sudan qeveria monitoronte komunikimin në Internet dhe gjatë zgjedhjeve bllokoi mundësinë e përdorimit të faqes së Internetit Vota e Sudanit. Qeveria e Kinës kontrollonte ngushtë përmbajtjen dhe mundësinë e përdorimit të Internetit dhe ndalonte ata që shprehnin pikëpamje kritike ndaj qeverisë apo politikave të saj. Në Vietnam qeveria drejtoi sulme kundër faqeve të Internetit dhe spiunoi shkruajtës blogesh disidentë. Policia arrestoi 25 disidentë gjatë vitit dhe hyri me forcë në shtëpitë e shumë të tjerëve për të hequr kompjuterat, celularët dhe materiale të tjera.

Prirja e tretë, me kah negativ, ishte vazhdimësia e përshkallëzimit të dhunës, persekutimit dhe diskriminimit zyrtar dhe shoqëror të anëtarëve të grupeve të prekshme, shpesh raciale, fetare ose pakica etnike apo shumica të shfuqizuara. Në shumë vende ky shabllon diskriminimi prekte dhe gratë; fëmijët; personat me aftësi të kufizuara; indigjenët; lezbiket; personat gay, biseksualë dhe transgjini (LGBT) dhe anëtarë të grupeve të tjera të prekshme që nuk kishin fuqi politike për të mbrojtur interesat e tyre. Anëtarëve të këtyre grupeve shpesh u mohohej mundësia ekonomike ose mundësia për t'u pajtuar me traditat ose praktikat e tyre sociale ose kulturore apo kufizoheshin në mundësinë për të folur të lirë, të mblidheshin të lirë, të formonin shoqata ose organizata.

Në Pakistan vazhduan shkeljet e lirisë së besimit fetar, dhuna dhe diskriminimi kundër pakicave fetare. Ligjet e blasfemisë përdoreshin për të sulmuar pakicat fetare si edhe muslimanët e cënueshëm e ata më pikëpamje pakice. (Në dy muajt e parë të vitit 2011 u vranë brutalisht dy zyrtarë të lartë qeveritarë të cilët sfiduan ligjet publikisht.) në Arabinë Saudite pati kufizime të rënda mbi lirinë e besimit fetar dhe diskriminimi në bazë të fesë ishte dukuri e zakonshme. Në Kinë qeveria vazhdoi të demonizonte Dalai Lamën dhe të shtypte egërsisht muslimanët Ujgurë në Xinjiang dhe Budistët tibetianë. Pati raporte në lidhje me veprime antisemitike anekënd botës, përfshirë përdhosjen e varrezave, mbishkrime, retorikën shpifëse për përdorjen e gjakut të fëmijëve për rite fetare si edhe mohimin e holokaustit, revizionizmin dhe mbulimin me lavdi. Ka pasur gjithashtu kunja në shprehjen e antisemitizmit gjatë ngjarjeve në Lindjen e Mesme.

Persona në gjithë botën vazhdojnë të përjetojnë diskriminim dhe kanosje bazuar në preferencat seksuale apo identitetin gjinor. Hondurasi përjetoi rritje të madhe të vrasjeve të pjesëtarëve të komunitetit LGBT nga autorë të njohur. Ndërkohë, në shumë kombe të Afrikës, Lindjes së Mesme dhe Karaibeve, marrëdhëniet brenda të njëjtit seks mbeten akte kriminale; nëpërmjet këtyre ligjeve dhe masave të tjera shteti përforcon dhe inkurajon diskriminimin dhe intolerancën shoqërore. Në Uganda, për shembull, u

përkeqësua gjatë vitit kanosja dhe sulmi ndaj individëve LGBT; disa drejtues qeveritarë e fetarë kërcënuan individë të komunitetit LGBT.

Shfrytëzimi i punëtorëve ishte problem gjithashtu në shumë vende, shpesh kombinuar me kërcënime kundër punëtorëve për shkak të përpjekjeve të tyre për t'u organizuar në sindikata. Përsëri në vitin 2010, qeveria e Uzbekistanit vuri në lëvizje mijëra të rritur dhe fëmijë si punëtorë të detyruar gjatë korrjes vjetore të pambukut. Në Banglandesh kushtet e këqija të punës shkaktuan vdekje të panevojshme, në mënyrë të dukshme në industrinë e veshjeve. Banglandeshi ishte gjithashtu vendi i trazirave të shpeshta të punëtorëve e ndonjëherë vdekjeprurëse, veçanërisht në Sektorin e Veshjeve të Gatshme dhe Zonat e Përpunimit për Eksport.

Këto prirje ilustrohen më tej më poshtë nga skicat e përmbledhura të 27 shteteve (të listuara alfabetikisht sipas rajoneve). Seksioni mbi shtetet nxjerr në pah shembuj të prirjeve të të drejtave të njeriut në vitin 2010. Në disa prej shteteve ka pasur zhvillime negative. Në shtete të tjera të theksuara më poshtë pasqyrojmë prirje pozitive në vitin 2010. Trungu i raportit është analizë shumë më e detajuar e këtyre shteteve dhe e 167 të tjerave.

Viti 2010 shënon vitin e 35-të që Departamenti i Shtetit nxjerr të përvitshmin *Raport të Shteteve mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut.* Raporti i këtij viti mbulon kushtet e të drejtave të njeriut në 194 shtete. Ajo që nisi si përgjigje e një mandati të Kongresit për të raportuar mbi situatën e të drejtave të njeriut në shtetet që merrnin ndihmë nga SHBA-ja në mesin e viteve 1970, ka lulëzuar tani në një analizë të detajuar të kushteve të të drejtave të njeriut në gjithë shtetet që janë anëtare të Kombeve të Bashkuara. Raportet e shteteve japin pamje të përgjithshme të situatës së të drejtave të njeriut anekënd botës si mjet për të rritur ndërgjegjësimin për kushtet e të drejtave të njeriut, në veçanti pasi këto kushte ndikojnë në mirëqenien e grave, fëmijëve, pakicave raciale dhe fetare, viktimave të trafikimit, anëtarëve të grupeve indigjene dhe komuniteteve etnike, personave me aftësi të kufizuara, pakicave seksuale, refugjatëve dhe anëtarëve të grupeve të tjera të prekshme.

Ashtu siç është rritur fusha e raportimit të Departamentit të Shtetit, është rritur edhe përdorimi i këtyre raporteve anekënd botës. Përveçse i japin të dhëna Kongresit për të informuar vendimet e tij në lidhje me fondet e politikat, këto raporte përdoren edhe në gjithë qeverinë e SHBA-së dhe nga shumë qeveri të huaja. Çfarë është më e rëndësishme akoma, ato po përdoren gjithmonë e më shumë nga shtetas e OJQ si burime kritike informacioni në lidhje më ato që po ndodhin në botë. Raportet janë

përkthyer në 50 gjuhë dhe janë vendosur në faqen e internetit të DASH për të lehtësuar përdorimin e këtij informacioni.

Qeveria e SHBA-së e harton raportin e të drejtave të njeriut sepse besojmë se është e detyrueshme për vendet, përfshirë edhe vendin tonë, të mundësojnë që respektimi i të drejtave të njeriut të jetë pjesë përbërëse e politikës së jashtme. I japim këto raporte në formë pasqyre dhe analize të përgjithshme.

Raporti nuk mbulon të drejtat e njeriut në Shtetet e Bashkuara, megjithëse administrata e tanishme ka ndërmarrë angazhimin të shikojë nga afër e me sy kritik qëndrimin tonë ndaj këtyre çështjeve edhe ndërsa hedhim dritë mbi praktikat e shteteve të tjera. Në nëntor Shtetet e Bashkuara paraqitën raportin e parë mbi të drejtat e njeriut në Shtetet e Bashkuara. Ky raport iu paraqit Këshillit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara (UNHCR) në Gjenevë nëpërmjet Pasqyrës Periodike Universale. Gjatë përgatitjeve për atë raport, ne kryem konsultime të gjera në Shtetet e Bashkuara me një sërë organizatash të shoqërisë civile dhe drejtuesish të amerikanëve autoktonë. Muajin e kaluar u paraqitëm përsëri në një takim të UNHCR-së në Gjenevë për të raportuar përgjigjet tona ndaj rekomandimeve që na u bënë nga qeveritë e tjera.

Gjithashtu ne raportojnë rregullisht në detyrimet e marrëveshjeve mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në vendin tonë. Në janar të vitit 2010 dorëzuam raporte periodike mbi zbatimin nga ana jonë të Protokolleve Fakultative bërë Konventës së të Drejtave të Fëmijës. Në vitin 2011 do të dorëzojmë raporte periodike në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat civile dhe Politike, Konventës Kundër Torturës dhe Konventës për Shfarosjen e Diskriminit Racial. Në vitin 2010 u përfshi për herë të parë në Shtetet e Bashkuara një seksion në *Raportin e Trafikimit të Personave* të Departamentit të Shtetit, dhe Shtetet e Bashkuara u renditën sipas të njëjtëve standarte që përdorim për vendet e tjera.

Dhe një fjalë të fundit në lidhje me prodhimin e këtyre raporteve. Këto 194 raporte shtetesh janë gjithëpërfshirëse, në mos shteruese. Prodhimi i tyre është sprovë herkuliane që kërkon përpjekje të jashtëzakonshme nga një skuadër punonjësish të talentuar dhe të përkushtuar të të drejtave të njeriut në ambasadat e SHBA-së anekënd botës, dhe nga bashkëpunëtorët e tyre ne Uashington, D.C., përfshirë edhe stafin e përkushtuar në Byronë e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Punës. Çdo skuadër e një shteti mbledh, analizon dhe sintetizon informacionin nga burime të ndryshme, përfshirë organizata vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, qeveri të tjera, organizata shumëpalëshe dhe anëtarë të shoqërisë civile. Pasi shkruhen në dorë të

parë këto raporte redaktohen me rigorozitet, shqyrtohen dhe vërtetohen faktet për t'u siguruar për saktësi dhe objektivitet.

Përshkrimet e Shteteve

Në vitin 2010 qeveritë anekënd botës vazhduan të kryenin shkelje dhe abuzime të rënda të të drejtave të njeriut. Paragrafët e mëposhtëm përshkruajnë situatën e të drejtave të njeriut dhe prirjet kyçe në shtete të caktuara ku abuzimet kanë qenë në mënyrë të veçantë të rënda. Theksojmë gjithashtu Ukrainën, ku në vitin 2010 pati kthim prapa pas zhvillimeve pozitive në vitet e mëparshme. Seksioni fillon me diskutimin e disa shteteve – Kolumbia, Guinea, Indonezia – të cilët theksohen për zhvillime pozitive të dukshme të të drejtave të njeriut në vitin 2010.

Kolumbia është një vend ku pati përmirësime të dukshme në situatën e të drejtave të njeriut në vitin 2010. Pak kohë pas marrjes së detyrës në gusht, presidenti Santos dhe administrata e tij forcuan marrëdhënien e qeverisë me shoqërinë civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke mbajtur seanca konsultimi të një niveli të lartë, duke shprehur publikisht mbështetjen për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe duke i angazhuar ata në dialog, si edhe duke mbështetur përpjekjet për të rritur dënimet për kërcënim dhe dhunim kundër mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Qeveria shtoi një Ligj për Tokën dhe Viktimat për të garantuar rikthim toke dhe ndreqje të viktimave. Ekzekutimet pa gjyq ranë ndjeshëm nga vitet 2008 dhe 2009 dhe disa oficerë madhorë policie u dënuan për abuzime me të drejtat e njeriut. Vazhduan disa abuzime të të drejtave të njeriut, si për shembull kërcënime ndaj mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe sindikalistëve. Ministria e Mbrojtjes filloi zbatimin e një marrëveshjeje me zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të OKB-së për të monitoruar masat e qeverisë për të përmirësuar respektimin e të drejtave të njeriut.

Në dhjetor të vitit 2010 **Guinea** inauguroi presidentin e saj të parë të zgjedhur në mënyrë demokratike që nga pavarësia nga Franca në vitin 1958. Populli zgjodhi si president pas dy raunde zgjedhjesh udhëheqësin për një kohë të gjatë të opozitës Alpha Conde, kandidatin e Partisë Grumbullimi i Popullit të Guineas. Edhe pse pati dhunë pas raundit të dytë, zgjedhjet në përgjithësi u vërejtën si të lira dhe të drejta.

Në **Indonezi** vazhdoi përmirësimi i respektimit të të drejtave të njeriut në vitin 2010, 12 vjet pas tranzicionit të vendit për në demokraci. Ndërkohë që sistemi i drejtësisë vazhdoi të kishte dobësi, presidenti Susilo Bambang Yudhoyono, i rizgjedhur në mënyrë demokratike në korrik të vitit 2009, mbeti mbështetës i flaktë i rendit, përgjegjshmërisë dhe shoqërisë civile, dhe media mbeti më e gjalla në Azi. Vazhdoi profesionalizimi i

ushtrisë, megjithëse ndodhën disa abuzime të rënda të të drejtave të njeriut nga personeli ushtarak, në veçanti në Papua dhe dënimët kur jepeshin, shpesh nuk ishin në proporcion me krimet e kryera.

AFRIKA

Bregu i Fildishtë e mbylli vitin 2010 në situatë të bllokuar ndaj presidencës pas zgjedhjeve të tetorit në të cilat presidenti në detyrë Laurent Gbagbo, kandidat i Frontit të Popullit të Fildishtë, dhe drejtuesi i partisë së opozitës Alassane Outtara, kandidati i Tubimit për Republikanët, shkuan në balotazhin presidencial të 28 nëntorit. Në 2 dhjetor Komisioni i Pavarur Elektoral deklaroi fitues Ouattara-n me 54.1 përqind të votave krahasuar me 45.9 përqind për Gbagbo-n. Zgjedhjet u deklaruan të drejta dhe demokratike nga OKB-ja dhe misionet e vëzhgimit vendase dhe ndërkombëtare. Gbagbo nuk i pranoi rezultatet, duke nxjerrë si shkak mashtrim votuesish dhe kanosje në disa rajone, dhe si Ouattara dhe Gbagbo bënë betimin për detyrën e presidentit në 3 dhjetor. Deri në fund të vitit, Ouattara e drejtonte qeverinë e tij nga Hoteli Golf në Abixhan nën bllokadë nga forcat pro Gbagbo-së. Gbagbo vazhdoi të kontrollonte burimet shtetërore përfshirë stacionin televiziv kombëtar, forcat e sigurisë dhe thesarin. Pati raporte të besueshme mbi abuzime me të drejtat e njeriut gjatë kësaj kohe. Në 16 dhjetor forcat e sigurisë hapën zjarr mbi mbështetësit e presidentit Ouattara nga një marshim demonstrativ. U vranë të paktën 20 persona, shumë të tjerë u plagosën dhe qindra u arrestuan. Në periudhën një javore nga 15 deri në 22 dhjetor Operacioni i OKB-së në divizionin e të drejtave të njeriut në Bregun e Fildishtë raportoi 173 persona të vrarë, 90 nënshtruar torturës dhe keqtrajtimit, 471 të tjerë të arrestuar në mënyrë arbitrare dhe të ndaluar dhe 24 persona të humbur. Pjesa dërrmuese e këtyre rasteve vrasjesh pa gjyq, torture, arresti dhe zhdukjeje u kryen nga forcat e sigurisë besnike ndaj Gbagbo-s. Cënimet e të drejtave të njeriut që ndodhën pas 31 dhjetorit nuk janë të dokumentuara në raportin e vitit 2010.

Abuzime të rënda me të drejtat e njeriut vazhduan të ndodhnin në gjithë **Republikën Demokratike të Kongos (RDK),** veçanërisht në rajonet lindore dhe verilindore, të pasura në minerale dhe në konflikt, ku autoriteti i shtetit mbeti joekzistent dhe tejet i dobët. Mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë kërcënuar, rrahur dhe, si në rastin e aktivistit të shquar Floribert Chebeya, vrarë. Qenie të armatosura – përfshirë dhe forca shtetërore të sigurisë – kryen abuzime pa marrë ndëshkim dhe u morrën me shfrytëzim të paligjshëm dhe tregti të burimeve natyrore, veçanërisht minerale. Të ardhurat që vinin nga tregtia e paligjshme me minerale, disa prej të cilave mbështesnin konfliktin e armatosur, e nxitën pasigurinë e vazhdueshme në RDK-në lindore, duke rënduar kështu një situatë të rrezikshme të të drejtave të njeriut. Grupe rebele dhe të milicisë në RDK-

në lindore vazhduan të përfshiheshin në përdhunime dhe fushata grabitjeje në përpjekje për të kontrolluar komunitetet e vendosura pranë zonave fitimprurëse të minierave, dhe për të korrur fitimet lidhur me aktivitete minierash që mbështesnin konfliktin dhe abuzimet që e shoqëronin atë. Burime të besueshme, si Grupi i Ekpsertëve të OKB-së në RDK, paraqitën informacione që tregonin se disa linja furnizimi të korporatave kongoleze dhe ndërkombëtare e kishin zanafillën në furnizues të cilët bënin tregti me forcat e armatosura – përfshirë edhe elemente të forcave shtetërore të sigurisë – të cilat kryenin abuzime të rënda të të drejtave të njeriut.

Nigeria vazhdoi të ishte e pllakosur nga abuzime të rënda të të drejtave të njeriut gjatë vitit. Anëtarë personeli të forcave të sigurisë, përfshirë policë, ushtarakë dhe oficerë të Shërbimit Shtetëror të Sigurisë, kryen vrajse pa gjyq dhe torturuan, rrahën dhe abuzuan me demonstrues, të dyshuar për krime, të arrestuar dhe të burgosur që kishin marrë dënimin. Taskforca e Bashkuar, e formuar në vitin 2003 për të zgjidhur situatën e paqendrueshme në Delta Niger dhe që përbëhej nga ushtarakë, forca policie dhe të shërbimeve të sigurisë, kryen sulme ndaj grupe militantësh dhe të dyshuarve për krime, duke çuar në shumë vdekje dhe lëndime si ndaj të dyshuarve si kriminelë dhe civilëve. Korrupsioni ishte i përhapur në të gjitha nivelet e qeverisë dhe në gjithë forcat e sigurisë. Dhuna etno-fetare çoi gjithashtu në vdekje e zhvendosje gjatë vitit. Etnikët dhe fermat rrethuese ishin objektet e dy sulmeve të mëdha në janar dhe mars. Deri në 1000 persona, më së shumti gra, fëmijë dhe të moshuar, u vranë, copëtuan për vdekje dhe u dogjën të gjallë.

Dhuna vazhdoi në **Sudan** gjatë gjithë vitit 2010. Zgjedhjet mbarëkombëtare të mbajtura në prill nuk u vlerësuan të drejta dhe të lira nga komuniteti ndërkombëtar, dhe vëzhguesit vunë re një sërë problemesh gjatë procesit. Në Darfur luftimet që përfshinin qeverinë, milicinë përkrah qeverisë, grupet rebele dhe grupet etnike vazhduan të vrisnin, lëndonin dhe zhvendosnin civilë. Kjo dhunë vrau 2321 persona gjatë vitit, sipas OKB-së, një rritje krahasuar me 875 persona të vrarë në vitin 2009. Qeveria vazhdoi të bënte bombardime ajrore. Dhuna me bazë gjinore, përdorja e fëmijëve ushtarë dhe bllokimi i organizatave humanitare dhe Misionit të Hibridit të Bashkimit të Afrikës i Kombeve të Bashkuara në Darfur vazhduan të përbënin problem. Qeveria sulmoi, arrestoi dhe rrahu anëtarë të shoqërisë civile në veri. Në Sudanin jugor luftimet ndëretnike dhe sulmet e Ushtrisë së Rezistencës së Zotit vazhduan të vrisnin dhe zhvendosnin civilë. Sipas përllogaritjeve të OKB-së, dhuna në jug rezultoi në 986 vdekje dhe në zhvendosjen e 223708 personave gjatë vitit. Në nëntor dhe dhjetor ndodhi regjistrimi për referendumin e vetëvendosmërisë së Sudanit jugor për vitin 2011. Mungesa e përparimit në përgatitjet për referendum të veçantë për të vendosur nëse

rajoni kufitar i Abyei-t duhet të ishte pjesë e veriut apo jugut çoi në dhunë sporadike dhe rritje tensionesh në zonë.

Në **Zimbabve** forcat e sigurisë, policia dhe elementë të dominuar nga Fronti Patriotik i Njësisë Kombëtare Afrikane të Zimbabves (ZANU-PF) i qeverisë vazhduan të kryenin cënime të shumta serioze të të drejtave të njeriut pa u ndëshkuar, përfshirë tortura, kundër aktivistëve politikë që nuk i përkisnin ZANU-PF-së dhe anëtarëve të partisë, drejtuesve të studentëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile. Kontrolli dhe manipulimi i procesit politik prej ZANU-PF nëpërmjet akuzave të sajuara dhe arrestimeve arbitrare, kërcënimit dhe korrupsionit mohuan të drejtën e shtetasve për të ndryshuar qeverinë e tyre. Megjithëse pati më pak incidente në gjysmën e parë të vitit 2010, shpresat se zgjedhjet do të mbaheshin në vitin 2011 çuan në rritjen e numrit të rasteve të sulmit dhe kërcënimit të organizatave të shoqërisë civile dhe anëtarëve të medias nga fundi i periudhës së raportimit. Qeveria vazhdoi të përdorte ligje shtypëse për të shtypur lirinë e fjalës, edhe për anëtarë të shtypit, lirinë e grumbullimit, shoqërimit dhe lëvizjes. Forcat dhe agjentë të tjerë të qeverisë vazhduan abuzimet në fushat e diamantit në Marange.

AZIA LINDORE DHE PAQËSORI

Pavarësisht lirimit të Aung San Suu Kyi, mbi 2100 të burgosur politikë mbetën nën arrestim në **Burma** në fundin e vitit 2010. Shumë aktivistë të shoqërisë civile u ndaluan pa afat dhe pa akuza, dhe organizata të sponsorizuara nga regjimi u përfshinë në sulme dhe abuzime të të drejtave të njeriut dhe të aktivistëve mbështetës të demokracisë. Qeveria shkelte në mënyrë rutinë privacinë e individit dhe kufizonte liritë e fjalës, shtypit, grumbullimit, pjesëmarrjes në shoqata, besimit fetar dhe lëvizjes. Qeveria nuk i lejoi OJQ-të vendase të të drejtave të njeriut të funksiononin të pavarura, ndërsa OJQ-të ndërkombëtare hasën mjedis të vështirë. Zgjedhjet e vjeshtës të vitit 2010 nuk ishin as të lira as të drejta. Qeveria vazhdoi kontrollin e ngushtë mbi aktivistët e klerikës Budiste. Forcat ushtarake në Burma vazhduan të kryenin abuzime skandaloze dhe dhunime kundër civilëve në rajone të pakicave etnike. Këto abuzime përfshinin përdhunime, torturë, zhvendosje të detyruar dhe punë të detyruar. Vazhdoi dhuna dhe diskriminimi shoqëror ndaj grave dhe komuniteteve të pakicave fetare, ashtu siç vazhdoi rekrutimi i paligjshëm i ushtarëve fëmijë dhe trafikimi i personave, në veçanti i grave dhe vajzave. Të drejtat e punëtorëve mbetën të kufizuara dhe vazhdoi puna e detyruar, përfshirë dhe ajo e fëmijëve.

Në **Kamboxhia,** pjesëtarë të forcave të sigurisë kryen vrasje arbitrare, pa marrë ndëshkim. Monitoruesit e të drejtave të njeriut raportuan arrestime arbitrare dhe ndalime të zgjatura paraburgimi, duke nënvizuar kështu një gjyqësor të dobët dhe mohim të të

drejtës për gjykim të paanshëm. Vazhduan kufizimet mbi lirinë për t'u grumbulluar të lirë dhe lirinë e fjalës, edhe për anëtarë të shtypit, dhe pati abuzim në rritje të shpifjes dhe padi dezinformuese që drejtoheshin te zërat e opozitës. Shoqëria civile shprehu shqetësime domethënëse se drafti i Ligjit mbi Shoqatat dhe OJQ-të, nëse do të miratohej, mund të ndrydhte seriozisht mundësinë e OJQ-ve për të vepruar. Draftligji i nxjerrë në dhjetor përfshinte dispozita që vendosnin kërkesa të rënda raportimi mbi OJQ-të, ndalonin shoqatat me më pak se 21 anëtarë (më vonë u ul në një numër akoma më të vështirë, 11) të merrnin status ligjor, ndërtonin pengesa të vështira për regjistrimin e OJQ-ve të huaja, u kërkonin OJQ-ve të huaja të bashkëpunonin me qeverinë dhe nxirrnin të jashtligjshme OJQ-të e paregjistruara. Vazhdoi veprimtaria kundër sindikatave nga punëdhënësit si edhe zbatimi i dobët i ligjeve të punës, dhe puna shfrytëzuese e fëmijëve në sektorin informal mbeti problem.

Në **Kinë** vazhdoi vala negative në fusha kyçe të të drejtave të njeriut. Qeveria rriti kufizimet për avokatët, aktivistët, bloguesit dhe gazetarët; shtërngoi kontrollet e shoqërisë civile dhe rriti përpjekjet për të kufizuar lirinë e fjalës dhe kontrolluar shtypin, Internetin, dhe përdorimin e Internetit në vitin 2010. Autoritetet rritën gjithashtu përdorimin e masave të jashtëligjshme, përfshirë zhdukjet e detyruara, arrestet shtëpiake të ashpra, arrestime arbitrare në "burgje të zinj" dhe forma të tjera të "ndalimit të butë" për të shtypur zërat e pavarur dhe dënuar aktivistët dhe familjet e tyre. Aktivisti ligjor Chen Guangcheng, bashkë me gruan dhe fëmijën e tij mbetën në arrest shtëpiak, si shumë të dënuar politikë të tjerë në lirim. Avokatëve të fushës publike, të cilit vepronin brenda kornizës ligjore të Kinës, iu hoq e drejta e avokatisë, u rrahën, ose u "zhdukën" pasi morën raste mbrojteje të klientëve dhe çështjeve që ishin përcaktuar si delikate nga qeveria. Bloguesit dhe mjeshtrat e faqeve të internetit janë arrestuar dhe akuzuar për "shkatërrim të fuqisë së shtetit" pasi kanë rivendosur një postim në tweeter apo kanë menaxhuar një faqe interneti ku kanë komentuar të tjerët. Qeveria vazhdoi gjithashtu shtypjen e rëndë kulturore dhe fetare të pakicave etnike në Rajonin e Pavarur të Xinjuang Uighur dhe zonave të Tibetit.

Në **Korenë e Veriut** situata e të drejtave të njeriut mbeti e zymtë. Gjatë vitit qeveria ruajti kontrolle të forta mbi rrjedhën e informacionit brenda dhe jashtë shtetit. Qeveria u mohoi qytetarëve të drejtën për proces të përshtatshëm gjyqësor dhe arrestoi në mënyrë arbitrare e ndaloi individë, përfshirë edhe me akuzën krime politike. Të dëmtuarit dhe OJQ-të treguan se ndodhën abuzime të rënda e sistematike të të drejtave të njeriut në mbarë rrjetin e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit në vend. Gjithashtu, qeveria vazhdoi të ushtronte kontrolle të ashpra mbi liritë e fjalës, shtypit, grumbullimit, shoqërimit, besimit fetar dhe lëvizjes si edhe të drejtave të njeriut. Nuk pati organizata monitoruese të pavaruara vendase për të drejtat e njeriut, ndërkohë që qeveria u mohoi

organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve të huaja mundësi veprimi, duke e bërë kështu të pamundur të llogaritje saktë shtrirjen e vërtetë të abuzimeve që ndodhnin në vend apo vlefshmërinë e këtyre raporteve.

Qeveria e **Vietnamit** vazhdoi të shtypte disidentët, shtërngoi kontrollet mbi shtypin dhe kufizoi liritë e fjalës, grumbullimit, lëvizjes dhe shoqërimit. Individët ndaloheshin në mënyrë arbitrare për veprimtari politike dhe u mohohej e drejta për gjykim të drejtë dhe të shpejtë. Qeveria arrestoi të paktën 25 aktivistë politikë, dha dënimin për 14 disidentë të arrestuar në vitet 2008, 2009 dhe 2010 dhe u mohoi apelim 10 disidentëve të tjerë që kishin marrë dënimin në fund të vitit 2009. Sistemi i drejtësisë u shtrembërua thellësisht nga ndikimi politik, korrupsioni endemik dhe paaftësia. Liria e besimit fetar vazhdoi të mbetej temë interpretimi dhe mbrojtjeje të pabarabartë, veçanërisht në nivelet e provincave dhe fshatrave. Liria e Internetit u kufizua më shumë ndërsa qeveria drejtonte sulme kundër faqeve kritike të Internetit dhe spiunonte bloguesit disidentë. Qeveria kufizoi të drejtat e punëtorëve për të formuar sindikata dhe për t'u bërë anëtarë të sindikatave të pavaruara.

EUROPA

Autoritetet në **Bjellorusi** arrestuan në mënyrë arbitrare, ndaluan dhe burgosën aktivistë mbështetës të demokracisë, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në zgjimin e zgjedhjeve të meta të dhjetorit të vitit 2010, autoritetet ndërmorrën goditje të gjerë kundër demonstruesve, duke ndaluar afro 700 persona dhe sulmuar zyra dhe apartamente që i përkisnin anëtarëve të medias së pavarur, OJQ-ve dhe opozitës politike. Mbi 40 individë, përfshirë edhe disa kandidatë presidencialë, përballen tani me deri në 15 vite burgim. Qeveria e Bjellorusisë, nëpërmjet arrestimeve dhe gjykimeve vazhdimisht shton të burgosur të rinj politikë. Gjyqësorit i mungonte pavarësia dhe vuante nga korrupsioni, paaftësia dhe ndërhyrja politike; rezultatet e gjykimeve shpesh ishin të paracaktuara dhe shumë gjykime shpesh bëheshin me dyer të mbyllura. Korrupsioni zyrtar në gjithë qeverinë vazhdoi të mbetej problem.

Në **Rusi** qeveria ndrydhi lirinë e fjalës, grumbullimit dhe shoqërimit, duke ndaluar disa demonstrues dhe duke ushtruar presion të vazhdueshëm për OJQ të caktuara, media të pavarura, disa pakica fetare, sindikata të pavaruara punonjësish dhe opozitën politike. Sulmi dhe vrasja e gazetarëve e aktivistëve vazhdoi. Pati raporte abuzimi fizik në zbatimin e ligjit, si edhe vdekje të detyruar nga ushtria dhe kushte të ashpra burgjesh. Cënimi i rendit dhe procesit të përshtashëm të gjykimit mbetën probleme dhe korrupsioni i qeverisë ishte i përhapur gjithandej. Sulme ksenofobike, raciale dhe etnike si dhe krimet e urrejtjes vazhduan të ishin probleme të mëdha. Konflikti midis qeverisë

dhe kryengritësve, militantëve islamikë dhe forcave kriminale në Kaukazin Verior çoi në dhunime të shumta të të drejtave të njeriut nga të gjitha palët, të cilat sipas raporteve u përfshinë në vrasje, tortura, abuzime, dhunë dhe rrëmbime me motive politike.

Në **Ukrainë,** pavarësisht fillimit me zgjedhje presidenciale të lira dhe të drejta, prirja e përgjithshme për vitin 2010 ishte negative si rezultat i zgjedhjeve lokale problematike, kanosje të medias dhe të atyre që u perceptuan si ndekje penale të figurave të opozitës. Vëshguesit ndërkombëtarë dhe vendas zbuluan se zgjedhjet lokale të tetorit nuk arritën të njëjtat standarde si ato presidenciale, dhe cituan regjistrimin e listave mashtruese të kandidatëve të opozitës, presion prej qeverisë ndaj monitoruesve të zgjedhjeve dhe kandidatëve, dhe zyrtarë të zgjedhjeve që përjashtonin ose hiqnin në mënyrë selektive kandidatë nga fletët e votimit – të gjitha këto nxitën shqetësimin rreth hapave të mëtejshëm që kishte planifikuar qeveria për reformë zgjedhore. Gjithashtu, pati raporte të shumta se autoritetet u përpoqën të drejtonin përmbajtjen e medias dhe kërcënonin gazetarët. Megjithëse qeveria morri masa në vitin 2009 për të luftuar korrupsionin, komuniteti ndërkombëtar shprehu shqetësimin se ishte politika ajo që nxiti hetimin kriminal të qeverisë në vitin 2010 për 30 anëtarë të qeverisë së mëparshme për akuza korrupsioni; disa prej këtyre njerëzve ishin ndaluar dhe si rrjedhim paditur.

LINDJA E AFËRT

Në javët që paraprinë zgjedhjet e tetorit në **Bahrain** shpërthyen tensione politike. Qeveria arrestoi më shumë se 200 burra Shia të cilët i akuzoi për nxitje dhe përfshirje të dhunës në rrugë. Mes të arrestuarve ishin disa, por jo të gjithë, prej drejtuesve të dy grupeve, Haq dhe Wafa, të cilët nuk pranojnë monarkinë dhe kishin bërë thirrje për bojkotim të zgjedhjeve. Qeveria akuzoi 23 prej të arrestuarve për përfshirje në “rrjetin e terrorit” në pajtim me ligjin kundër terrorizmit të vitit 2006. Procesi elektoral u dëmtua gjithashtu nga nxjerrja si të jashtëligjshme nga ana e qeverisë e dy faqeve të internetit të ligjshme të partive kryesore si edhe të buletineve të tyre. Qeveria nuk i lejoi vëzhguesit ndërkombëtarë të monitoronin zgjedhjet. Ajo vazhdoi gjithashtu të kufizonte liritë e grumbullimit dhe shoqërimit. Forcat e sigurisë ndërhynë në demonstrata dhe kufizuan e kontrolluan grumbullimet politike gjatë vitit. OJQ-ve dhe grupeve të shoqërisë civile u kërkohej të regjistroheshin në qeveri dhe të jepnin lista anëtarësie. Në shtator Ministria e Zhvillimit Social mbylli aktivitetin e një organizate të të drejtave të njeriut, Shoqëria e të Drejtave të Njeriut të Bahrainit, kur një dekret ministror urdhëroi shpërbërjen e bordit të drejtuesve të shoqërisë dhe emëroi një nëpunës të ministrisë si drejtues të përkohshëm të grupit.

Sipas një sërë burimesh, qeveria e **Iranit** ekzekutoi përreth 312 persona në ekzekutimet përmbledhëse gjatë vitit, shumë prej tyre pas gjykimeve të bëra në fshehtësi dhe/ose nuk siguroi proces të përshtatshëm gjykimi. Në shumë raste, personat e ekzekutuar për çfarë supozohej si shkelje penale si trafikimi të lëndëve narkotike, në të vërtetë ishin disidentë politikë. Autoritetet mbanin të burgosur politikë dhe vazhdonin të shtypnin reformuesit e të drejtave të grave , aktivistë të të drejtave të pakicave etnike, aktivistë studentorë dhe pakicat fetare. Pati shumë pak pavarësi gjyqësore dhe shumë pak gjykime të drejta publike. Qeveria kufizoi rëndë të drejtën e privacisë dhe lirive civile, përfshirë lirinë e të shprehurit, edhe për anëtarë të shtypit, lirinë e grumbullimit, shoqërimit dhe lëvizjes, si edhe vendosi kufizime të rënda mbi lirinë e besimit fetar. Vigjilentët vazhdonin të sulmonin të rinjtë e konsideruar "jo-islamikë" në veshje ose veprime, pushtonin shtëpi private, abuzonin me çiftet e pamartuar dhe ndërprisnin koncerte. Vazhdoi të kishte dhunë dhe diskriminim ligjor dhe shoqëror kundër grave, fëmijëve, pakicave etnike dhe fetare dhe personave të grupit LGBT.

Ndërsa zgjedhjet parlamentare kombëtare të ligjshme dhe të besueshme në 18 provinca në 7 mars pasqyruan arritje domethënëse në përparimin e ushtrimit të të drejtave të njeriut, dhuna e skajshme, bashkë me paraqitjen e dobët qeveritare në mbajtjen e rendit, çuan në abuzime të përhapura dhe të rënda të të drejtave të njeriut në **Irak.** Pati raporte se qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje të shumta arbitrare ose të paligjshme, ndalime arbitrare apo veprime torture të lidhura me operacionet e saj të sigurisë, shpesh këto të kryera pa marrë ndëshkim. Vazhduan sulmet nga Al-Kaeda në Irak dhe nga ekstremistë të tjerë kundër Forcave të Sigurisë së Irakut (FSI), zyrtarëve të qeverisë dhe civilëve, shpesh me pikëshënjestër zonat urbane, kishat e Krishtera, tregjet Shia dhe xhamitë. Në 10 maj bombardime e të shtëna të bashkerenduara çuan në të paktën 119 aksidente me vdekje, përfshirë personel të FSI-së dhe të zbatimit të ligjit. Në 17 gusht një kamikaz hodhi veten në erë në një turmë rekrutësh ushtarakë në Bagdad, duke vrarë 61 persona. Gjatë vitit, 962 pjesëtarë të personelit të Ministrisë së Brendshme u vranë dhe 1347 të tjerë u plagosën. Oficerët e policisë në veçanti ishin në shënjestër.

Në **Libi** Koloneli al-Qadhafi dhe kolegët e tij të ngushtë monopolizuan çdo aspekt të vendimmarrjes në qeveri. Problemet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut përfshinin torturë, arrestime arbitrare, mosndëshkueshmëri zyrtare dhe kushte të rënda në burgje. Një numër i madh por i panjohur personash mbeti në qendra paraburgimi ose burgje për përfshirje në aktivitete paqësore politike ose për përkatësi në ndonjë organizatë politike të jashtëligjshme. Qeveria kufizoi rëndë lirinë e medias dhe vazhdoi të kufizonte lirinë e të shprehurit; në mënyrë rutinë monitoronte telefonatat dhe përdorimin e Internetit, përfshirë komunikimin me postë elektronike me vende të huaja. Pati

gjithashtu mbikqyrje fizike të aktivistëve politikë dhe organizatave të huaja. Qeveria zotëronte dhe kontrollonte realisht të gjitha mediat e shkruara e të transmetimit, dhe media e kontrolluar nga qeveria as botonte as transmetonte mendime në mospërputhje me politikat zyrtare. Organizata e Sigurisë së Brendshme sulmonte gazetarët në mënyrë rutinë dhe shërbente si bazë për akuza të shpeshta për shpifje kriminale mbi dispozita të shtrira gjerësisht të kodit penal. Qeveria kufizoi rëndë lirinë e grumbullimit dhe lejonte mbledhje publike vetëm më aprovim paraprak. Qeveria kufizoi të drejtën e shoqërimit dhe në përgjithësi lejonte vetëm institucionet e lidhura me qeverinë që të kryenin aktivitet; asnjë OJQ nuk funskiononte në vend. Në muajt e parë të vitit 2011 shpërthyen protesta në gjithë Libinë. Për shkak se ndodhën përtej periudhës së raportimit, ato nuk dokumentohen në raportin e vitit 2010.

Në **Siri** forcat e sigurisë kryen vrasje të paligjshme, ndaluan aktivistë politikë dhe të të drejtave të njeriut dhe torturuan e abuzuan fizikisht të burgosurit dhe paraburgosurit, pa marrë ndëshkim. Qeveria burgosi gjithashtu një sërë anëtarësh të lartë të komunitetit të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile, përveç 2500-3000 të burgosurve politikë të ndaluar më parë. Periudha e stërgjatur para gjykimit dhe arrestimi i pakomunikuar mbetën probleme serioz, dhe gjykatat sistematikisht përdornin “rrëfimet” e nxjerra nën detyrim si prova. Paditë e të pandehurve për torturë pothuajse nuk hetoheshin kurrë. Qeveria kufizoi rëndë liritë universale të të shprehurit, grumbullimit dhe shoqërimit, besimit fetar dhe lëvizjes.

AZIA JUGORE DHE QENDRORE

Një situatë tejet e vështirë sigurie në **Afganistan** rezultoi në numër të madh abuzimesh me të drejtat e njeriut. Civilët vazhduan të vuanin nga konflikte të armatosura të intensifikuara ndërsa vdekjet në lidhje me konfliktin u shtuan me 15 përqind gjatë vitit krahasuar me vitin 2009. Qeveria dhe forca ndërkombëtare proqeveritare ishin përgjegjëse për vdekje të civilëve, në veçanti të 16 përqind të numrit total të vdekjeve të civilëve. Human Rights Watch (Vëzhguesi i të Drejtave të njeriut) raportoi se mungonin shpesh hetimet transparente dhe të bëra në kohë apo vënia përpara përgjegjësisë e forcave në raste shkeljeje në rastet kur vriteshin e lëndoheshin civilë. Talebanët dhe sulmet kryengritëse, përfshirë vrasjet më pikësynim politik, u rritën si në numër dhe në intensitet. Të paktën 30 individë u vranë në 18 shtator, dita e zgjedhjeve parlamentare, dhe Talebanët pohuan përgjegjesinë që kishin për vrasjen e tre kandidatëve gjatë periudhës së fushatës ndërmjet korrikut dhe gushtit. Në gusht pesë punonjës të fushatës në mbështjetje të Fauwzia Gilani në Herat u rrëmbyen dhe vranë. Pati sulme gjithashtu mbi zyrtarë të zgjedhjeve. Vetë zgjedhjet u dëmtuan nga mashtrimet elektorale dhe parregullsitë e gjithëpërhapura, përfshirë ngritjen e një gjykate të veçantë

për të hetuar rrezultatet e zgjedhjeve dhe ankesat; pjesëmarrje të ulët në votime; dhe kushte të pamjaftueshme për pjesëmarrjen e grave. Qeveria u pllakos nga mosndëshkueshmëria e zyrtarëve dhe e korrupsionit dhe shpesh nuk arriti të bënte hetime të suksesshme mbi abuzimet mbi të drejtat e njeriut të kryera nga forcat lokale të sigurisë. Arrestimet arbitrare dhe paraburgimet mbetën problem dhe gjyqësorit i mungonte pavarësia. U kufizua ndjeshëm liria e besimit fetar, përfshirë të drejtën për të ndryshuar besimin personal. Gratë vazhduan të përballeshin me abuzime të vazhdueshme të të drejtave të njeriut, përfshirë dhunën, sulmet kryengritëse mbi arsimimin e vajzave, mundësitë e kufizuara për drejtësi dhe kufizime të tjera të të drejtave të tyre.

Në **Pakistan** u raportuan deklarata për vrasje pa gjyq dhe arrestime të civilëve nga frocat e sigurisë, raportime këto të bëra nga një numër kompanish mediatike dhe OJQ-sh. Gjatë vitit pati një rritje të ndjeshme në numrin e përgjithshëm të torturave të raportuara dhe rasteve të përdhunimit në individëve nën arrest, pothuajse dyfish në krahasim me vitin 2009. Shoqëria për të Drejtat e Njeriut dhe Ndihmën për të Burgosurit raportoi 72 vdekje civilësh pas përballjesh me policinë dhe 168 vdekje në burgje, një rritje nga viti i mëparshëm. Bombardime ushtarake dhe terroriste në të katër provincat dhe në Zonat Fisnore të Administruara në Federatë vazhduan të shkaktonin vdekje dhe lëndime. Sipas raportit, sulme terroriste dhe ekstremiste dhe operacione për të luftuar terrorizmin dhe ekstremizmin çuan në 7400 vdekje, prej të cilave afro 1800 ishin civilë, mbi 450 ishin forca të sigurisë dhe mbi 5100 ishin terroristë e kryengritës. Pati një numër raportesh për vrasje me motive politike në Karachi dhe Balochistan. Sipas raportit të bërë nga *Dawn (Agimi),* 1981 persona u vranë gjatë dhunës politike në Karachi, prej të cilëve 748 ishin vrasje më pikësynim. Sipas Human Rights Watch, vrasjet e zhdukjet me pikësynim të drejtuesve Baloch, aktivistëve dhe civilëve u rritën në vitin 2010. Vazhduan cënimet e të drejtave të besimit fetar dhe dhuna e diskriminimi kundër pakicave fetare. Disa njerëz të akuzuar për blasfemi kundër Islamit u dënuan me burgim të përjetshëm ose dënim me vdekje. Një prej tyre ishte edhe Aasia Bibi, grua e krishterë e cila u dënua me vdekje në nëntor, duke u bërë kështu e para grua që merrte një dënim kaq të ashpër për blasfemi.

Uzbekistani vazhdoi të burgoste individët mbi baza politike. Ndërsa u lirua një i burgosur politik, aktivisti i të drejtave të njeriut Farhad Mukhtarov, gjatë vitit, 13 të burgosur politikë mbetën nën arrest, dhe anëtarët e familjeve raportuan se shumë të burgosur u torturuan. Aktivistë të të drejtave të njeriut, anëtarë të familjeve të tyre dhe anëtarë të disa grupeve fetare raportuan sulme dhe arrestime nga policia dhe anëtarë të tjerë të frocave të sigurisë. U kufizua rëndshëm liria e të shprehurit dhe sulmi ndaj gazetarëve u rrit gjatë vitit. Shërbimet e policisë dhe të sigurisë arrestuan gazetarë të

shtypit dhe televizionit, kërcënuan dhe përdorën dhunë si edhe kufizime burokratike mbi ta dhe veprimtarinë e tyre. Kodet penale dhe administrative vendosën gjoba të rënda për shpifje dhe përdhosje figure dhe qeveria përdori akuza shpifjeve, përgojimi dhe përdhosjeje për të dënuar gazetarë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe të tjerë që kritikonin presidentin dhe qeverinë. Liria e shoqërimit u kufizua gjithashtu. Qeveria kontrolloi ngushtë veprimtarinë e OJQ-ve dhe nxorri rregullore me kufizime ligjore strikte për islamikët dhe grupe pakicash fetare, kufizime mbi ç'lloj grupesh mund të formoheshin dhe regjistroheshin. U përdor punë e detyruar e të rriturve dhe fëmijëve gjatë korrjes së pambukut.

HEMISFERA PERËNDIMORE

Qeveria e **Kubës** liroi më shumë se 40 të burgosur politikë gjatë periudhës së raportimit, përfshirë shumë aktivistë të njohur të të drejtave të njeriut të arrestuar në vitin 2003. Mëgjithatë, shumica e tyre u liruan me kusht që të largoheshin nga vendi. Kuba vazhdoi të mbante dhjetëra të burgosur të tjerë politikë. Qeveria shtypi të drejtat e njeriut dhe liritë themeltare, si liria e fjalës, e shtypit, grumbullimit dhe shoqërimit, lëvizjes dhe besimit fetar. Grupet e të drejtave të njeriut vunë re një rritje të shënuar në përdorimin e arrestimeve me afat të shkurtër krijuar për të ndërprerë punën e shoqërisë civile dhe për të sulmuar aktivistët. Gjithashtu, qeveria vazhdoi të mbante protesta publike për të sulmuar dhe abuzuar me aktivistët dhe familjet e tyre, në veçanti me *Damas de Blanco* ("Gratë me të Bardha"). Megjithëse qeveria i përshkruante turmat si spontane, pjesëmarrësit shpesh vinin me mjete të qeverisë ose merreshin prej drejtuesve të Partisë Komuniste lokale nga vendet e punës ose shkollat e afërta. Në raste të skajshme, turma të drejtuara nga qeveria sulmonin këto individë dhe dëmtonin shtëpitë e tyre. Anëtarë të forcave të sigurisë monitoronin, sulmonin dhe ndonjëherë dëmtonin fizikisht mbështetës të të drejtave të njeriut dhe prodemokratë, disidentë, gazetarë të pavarur, të arrestuar, e të gjitha këto bëheshin pa marrë ndëshkim. Qeveria nuk njihte gazetarinë e pavarur dhe disa gazetarë të pavarur u bënë objekt ndalimi udhëtimi, arrestimi, sulmi, sekuestrimi pajisjesh dhe kërcënimesh për burgosje. Grumbullime të paautorizuara të më shumë se tre personave mund të ndëshkoheshin me deri në tre muaj burg ose gjobë, megjithëse këto takime më shpesh shpërbëheshin sesa ndiqeshin penalisht.

Respekti për të drejtat e njeriut dhe institucionet demokratike u përkeqësuan gjatë vitit të fundit në **Nikaragua.** Anëtarëve protestues të partisë së opozitës iu mohua liria e grumbullimit. Zgjedhjet rajonale të marsit të vitit 2010 në bregun e Karaibeve u dëmtuan nga deklarata në lidhje me parregullsi të përhapura gjithandej dhe OJQ-ve të besueshme vendase iu mohua leja për të monitoruar zgjedhjet. Çështje të tjera

përfshijnë politizimin e gjyqësorit dhe orgavene të tjera qeveritare, ndërhyrje e konsiderueshme nga ana e qeverisë në lirinë e medias, dhe sulme ndaj OJQ-ve dhe gazetarëve. Policia nuk i mbrojti demonstruesit të cilët protestuan ndaj politikave të qeverisë dhe lejoi grupet proqeveritare të angazhoheshin në veprimtari të dhunshme. Qeveria vazhdoi të kritikonte drejtuesit fetarë të cilët shprehën shqetësime për praktikat dhe politikat qeveritare që ndikonin pjesëmarrjen publike dhe liritë demokratike. Zyrtarët qeveritarë censuronin në mënyrë publike zyrtarë të Kishës Katolike të cilët denonconin manipulimin e procesit zgjedhor.

Në **Venezuelë** qeveria përdori gjyqësorin për të kërcënuar dhe persekutuar individë dhe organizata që kritikonin politikat ose veprimtarinë e qeverisë, përfshirë protestues paqësorë, gazetarë, një gjykatës, anëtarë të partive politike të opozitës, OJQ, drejtues sindikatash e biznesi dhe qytetarë të zakonshëm. Zyrtarë qeveritarë kufizuan gjithashtu lirinë e të shprehurit, duke sulmuar e kanosur stacione televizive private, grupe mediatike dhe gazetarë nëpërmjet kërcënimeve, sekuestrimeve të pasurisë, rregullore me pikësynim dhe hetime kriminale e ndjekje penale. Në fund të dhjetorit Asambleja Kombëtare miratoi një paketë ligjesh që dëmtojnë parimet dhe praktikat demokratike në Venezuelë, përfshirë një ligj që i delegon autoritetin legjislativ ekzekutivit që u shtri përtej mandatit në detyrë të Asamblesë Kombëtare në ikje, duke dhunuar vlerat e përbashkëta me Kartën Demokratike Ndëramerikane, dhe ligje që detyronin kufizime mbi median e pavarur, Internetin, partitë politike dhe OJQ-të.